

## **Ky është një mesazh I RENDESISHEM MBI SHENDETIN DHE VAKSINIMIN e fëmijës tuaj.**

### **Lexojeni[61] këtë mesazh në rast se keni marrë një letër nga Peel Public Health në lidhje me vaksinimin e fëmijes tuaj.**

Në bazë të ligjit, Peel Public Health (Drejtoria Shëndetësore të Peel), duhet t'i paraqiten vërtetime dhe dokumenta që tregojnë se fëmija juaj është vaksinuar (dhe imunizuar) plotësisht në përputhje me grafikun e vaksinimeve që aplikohet në Ontario. Peel Public Health nuk ka ndonjë dosje apo dokument ku të vërtetohet se fëmija juaj ka bërë gjithë vaksinat e duhura që bëhen në Ontario.

Mjeku i familjes nuk ka për detyrë që të raportojë dhe të informojë Peel Public Health për të dhëna që kanë të bëjnë me vaksinimin e fëmijes tuaj. Ju si prinder (ose si kujdestarë) duhet të na paraqisni dokumentat e vaksinimeve.

#### **VAKSINIMET E DUHURA**

Gjithë fëmijët që nuk kanë mbushur 18 vjec duhet të kenë bërë që në foshnjëri vaksinat për:

- difteri
- poliomilit
- tetanos
- fruth
- shytat (parotiti epidemik)
- Rubeola

Fëmijët duhet të vaksinohen me vaksinen e duhur në kohën e duhur.

#### **PARAQITJA E DOKUMENTAVE TE VAKSINIMEVE TE BERA**

Në rast se vaksinimet e fëmijës tuaj janë bërë sipas afateve, atëherë ju lutemi dërgoini menjëherë ato tek Peel Public Health në një nga mënyrat e mëposhtëme.

- **Na merrni ne telefon ne numrin 905-799-7700.** Ne mund të gjejmë dhe përkthyes në rast se keni nevojë për përkthim. Në rast se banoni në Caledon merrni në telefon numrin 905-584-2216.
- **Me kompjuter** (online) në adresën elektronike : [www.immunizepeel.ca](http://www.immunizepeel.ca)[63]
- **Mund t'i dergoni me postë ose t'i sillni dorazi në adresën:**

Immunization Records  
Peel Public Health  
7120 Hurontario Street  
P.O. Box 630  
Mississauga, ON L5M 2C5

Kini kujdes qe të na dërgoni vetëm KOPJE dhe – JO dokumentat origjinale – në rast se na i dergoni me postë. Ne rast se na i sillni në zyrë, mund të sillni origjinalet dhe ne mund të bëjmë kopje të tyre për dosjet tona.

## **NEVOJAT PER VAKSINA TE TJERA**

Ne rast se femija juaj duhet të bëjë një vaksinë atëhere:

- 1) Kërkoni një takim për vaksinim me Mjekun e familes ose shkoni në klinikën më të afërt mjekësore.
- 2) Me t'i bërë vaksinën fëmijës, **dërgojeni menjëherë dokumentin e vaksinimit në Peel Public Health.**

## **PJESEMARRJA NE SHKOLLE**

Nxënësit që nuk i kanë në rregull dokumentat e vaksinimeve **mund të mos lejohen të shkojnë në shkollë ose kopësht.** Peel Public Health (Drejtoria Shendetesore Peel) do t'iu ndihmojë që të plotësohen këto dokumenta në mënyrë që fëmijët të lejohen në shkollë. Letra që keni marrë me postë u jep datën përfundimtare brënda të ciles ju duhet t'i paraqisni Peel Public Health dokumentat e vaksinimit të fëmijës tuaj.

## **VAKSINIMET E BERA JASHTË KANADASE**

Peel Public Health ofron të përkthejë nga gjuha juaj në anglisht, pa pagese, dokumentat e vaksinimit të fëmijës tuaj. Na merrni në telefon në 905-799-7700 për të bërë një gjë të tillë. Në rast se banoni në Caledon, telefononi në 905-584-2216.

## **NE RAST SE NUK KENI KARTE OHIP?**

Në rast se fëmija juaj nuk ka kartën shëndetësore të Ontarios (Ontario Health Card - OHIP), ne do t'ia bëjmë vaksinimet falas.

Merrni në telefon Peel Public Health në numrin 905-799-7700 për të kërkuar një takim. Në rast se banoni në Caledon, merrni numrin 905-584-2216.

## **VAKSINAT MBROJNE SHENDETIN E FEMIJES TUAJ**

- Vaksinat mbrojnë fëmijët nga sëmundje të rrezikshme infektive.
- Kujdesuni që fëmijët të vaksinohen me gjithë vaksinat e nevojshme.
- Dërgojeni dokumentin e vaksinimit në Peel Public Health çdo herë që fëmija juaj ben një vaksinë.

Në rast se keni ndonjë pyetje na merrni në telefon në numrin **905-799-7700**. Në rast se banoni në Caledon, merrni numrin 905-584-2216. Ne mund t'iu gjejmë edhe përkthyes po të keni nevojë. Thoini personit që iu përgjigjet në telefon se ç'gjuhe flisni dhe ai do t'ju lidhi me një përkthyes që flet gjuhën tuaj.

Ju faleminderit.

Grupi i Dokumentimit të Vaksinimeve  
Peel Public Health